



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 1167, datë 10/02, 2016

PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT ELEKTRONIK
PËR REGJISTRIMIN DHE GJURMIMIN E TË DHËNAVE MBI RASTET E
KORRUPSIONIT DHE STATISTIKAVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 6, pika 15, dhe nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, si dhe nenit 37 dhe 38 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Kancelarët e gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda të përdorin Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara, ku do të hidhen dhe përditësohen të dhëna mbi çështjet gjyqësore me objekt veprat penale të korrupsionit të paraqitura në gjykatat ku ushtrojnë funksionin.
2. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara (në vijim referuar si "Sistemi Elektronik") është baza e të dhënave shtetërore, krijuar me Vendim nr. 824, datë 07.10.2015, të Këshillit të Ministrave, i cili është i hostuar në serverat e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).
3. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara u vihet në dispozicion gjykatave në formatin *web-based* në faqen www.act-albania.al.
4. Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara administrohet nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore si Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit.
5. Grumbullimi i të dhënave të përditësuara mbi çështjet gjyqësore me objekt veprat penale të korrupsionit në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara ka si qëllim:
 - a) Mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të rasteve të korrupsionit, si dhe gjurmimin e fazave procedurale të gjykimit penal në kohë reale;


- b) Lehtësimin e veprimtarisë së Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit në monitorimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura për rastet e korrupsionit;
- c) Përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara të gjeneruara nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit; si dhe
- d) Unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e korrupsionit.
6. Sistemi Elektronik përmban formularë sipas formatit bashkëngjitur këtij urdhri si Shtojca 1 (Raportim i Gjykatës së Shkallës së Parë) dhe Shtojca 2 (Raportim i Gjykatës së Apelit) të miratuar nga administratori i Sistemit.
7. Kancelari i gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda pranë së cilës regjistrohet çështja gjyqësore me objekt veprat penale të korrupsionit plotëson dhe përditëson elektronikisht brenda njëzet e katër orëve nga momenti i regjistrimit të çështjes apo kryerjes së veprimeve procedural fushat e Raportimit të Shtojcës 1.
8. Kur vendimi penal për një çështje të regjistruar më parë në Sistemin Elektronik merr formë të prerë në përputhje me ligjin, në gjykatën e shkallës së parë, kancelari i gjykatës së shkallës së parë e cila ka dhënë vendimin do të reflektojë dhe përditësojë këtë fakt në Sistem.
9. Kancelari i gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda pranë të cilës regjistrohet çështja gjyqësore me objekt veprat penale të korrupsionit, plotëson dhe përditëson elektronikisht brenda njëzet e katër orëve nga momenti i regjistrimit të çështjes apo kryerjes së veprimeve procedural fushat e Raportimit të Shtojcës 2.
10. Kancelari është përgjegjës për saktësinë dhe koherencën e të dhënave të hedhura prej tij në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara.
11. Të dhënat dhe informacioni i ruajtur në Sistemin Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara mund të përdoren, përpunohen, transmetohen, përhapen ose riprodhohen vetëm për qëllimet e parashikuara në paragrafin 5 të këtij Urdhri, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12. Niveli i aksesit të kancelarëve të gjykatave dhe modalitetet teknike të përdorimit të Sistemit Elektronik përcaktohen në Vendimin Nr.824, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, administrimin dhe përdorimin e Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara” dhe Rregulloren e Përdorimit të Sistemit Elektronik, miratuar nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit.
13. Kancelari i gjykatës mund të caktojë një apo më shumë nëpunës të gjykatës të cilët do jenë përdoruesit e Sistemit Elektronik për gjykatën, do të ndjekin trajnimet e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit mbi përdorimin e Sistemit Elektronik, do të kenë akses të drejtpërdrejtë në llogarinë e gjykatës dhe do të hedhin të dhënat e kërkuara në Sistemin Elektronik, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e kancelarit në zbatim të këtij Urdhri.
14. Kancelari njofton me shkrim Ministrinë e Drejtësisë brenda 3 (tre) ditëve mbi caktimin e përdoruesit sipas pikës 13 të këtij Urdhri.
15. Në funksion të përdorimit me efektivitet të Sistemit Elektronik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë koordinon dhe bashkërendon punën ndërmjet kancelarëve të gjykatave dhe Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

16. Ministria e Drejtësisë ndjek zbatimin e këtij Urdhri duke ushtruar kontrolle periodike dhe udhëzuar kancelarët, në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, mbi përdorimin e Sistemit.
17. Përdorimi i Sistemit Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij Urdhri.
18. Kancelarët e gjykatave të shkallës së parë do të hedhin në Sistem të dhënat mbi çdo vendim penal të formës së prerë me datë procedimi duke filluar nga 1 qershor 2014 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Urdhri sikurse kërkohet në Shtojcën 1 dhe 2, përfshirë dhe vendimet penale të Gjykatës së Lartë sipas Shtojcës 3 bashkëlidhur, brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij Urdhri.
19. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri kancelarët e gjykatave të retheve gjyqësore, gjykatave të apelit, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.
20. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

YLLI MANJANI



SHTOJCA NR. 1 Formulari për të dhënat e gjykatës së shkallës së parë



REPUBLIKA E ALBANIS
MINISTRIA E JUSTITËS
PËR ÇESHTJET VENDORE

**Koordinatori Kombëtar
Antikorrupsion**

Raportim i Gjykatës së Shkallës së Parë

1) Të dhënat e dosjes

Numri i regjistrimit të dosjes në gjykatë:

Data e regjistrimit të dosjes në gjykatë:

Numri dhe data e Proclimit:

Çështje e kthyer për gjykim:

2) Personat e pandehur

Numri i personave të pandehur:

Pozicioni 1: Pozicioni 5:

Pozicioni 2: Pozicioni 6:

Pozicioni 3: Pozicioni 7:

Pozicioni 4: Pozicioni 8:

3) Nenet e Korrupsionit sipas Akuzës së

☐ Neni 135	☐ Neni 257	☐ Neni 319/a
☐ Neni 164/a	☐ Neni 257/n	☐ Neni 319/b
☐ Neni 244	☐ Neni 258	☐ Neni 319/c
☐ Neni 244/a	☐ Neni 259	☐ Neni 319/ç
☐ Neni 245	☐ Neni 259/a	☐ Neni 319/d
☐ Neni 245/1	☐ Neni 260	☐ Neni 319/dh
☐ Neni 248	☐ Neni 312	☐ Neni 319/e
☐ Neni 256	☐ Neni 319	

4) Lloji i Gjyimit

☐ Gjykim ☐ Gjykim i drejtpërdrejtë ☐ Gjykim i shkurtuar

Numri dhe data e Vendimit:

5) Vendimi Gjykatës dhe Personat e Dënuar:

☐ Pushim i çështjes

☐ Vendim pajtësie

☐ Transferuar në një gjykatë tjetër

☐ Akuzë e re e cila nuk klasifikohet si rast korrupsion

☐ Përzullim Gjykim

☐ Kthyer për hartim të mëtejshme

☐ Vendim dënim

Numri dhe data e Vendimit:

Numri dhe data e Vendimit:

Numri i personave të dënuar :

Pozicioni 1:

Pozicioni 5:

Pozicioni 2:

Pozicioni 6:

Pozicioni 3:

Pozicioni 7:

Pozicioni 4:

Pozicioni 8:

6) Nenot e
Korrupsionit dhe
Lloji i Dënimit
të Gjykatës

☐ Neni 135

☐ Neni 257

☐ Neni 319/a

☐ Neni 164/a

☐ Neni 257/a

☐ Neni 319/b

☐ Neni 244

☐ Neni 258

☐ Neni 319/c

☐ Neni 244/a

☐ Neni 259

☐ Neni 319/ç

☐ Neni 245

☐ Neni 259/a

☐ Neni 319/d

☐ Neni 245/1

☐ Neni 260

☐ Neni 319/dh

☐ Neni 248

☐ Neni 312

☐ Neni 319/e

☐ Neni 256

☐ Neni 319

Lloji i Dënimit:

☐ Dënim me Burg

☐ Dënim me Gjobë

☐ Të dyja

7) Vendimi ka
Marrë Formë të
Prerë:



Koordinatori Kombëtar
Antikorrupsion

Reportim i Gjykatës së Apelit

1) Të Dhënat e
Dosjes

Gjykata nga ku ardhur është:

Numri i regjistrimit të dosjes në gjykatë:

Data e regjistrimit të dosjes në gjykatë:

Numri dhe data e procedimit:

Numri dhe data e protokollit të prokurorisë:

Cështje e kthyer për gjykim: ☐

2) Personat e
Pandehur

Numri i personave të pandehur:

Pozicioni 1:

Pozicioni 2:

Pozicioni 3:

Pozicioni 4:

Pozicioni 5:

Pozicioni 6:

Pozicioni 7:

Pozicioni 8:

3) Nenët e
Korrupsionit
Sipas Akuzës

☐ Neni 135	☐ Neni 257	☐ Neni 319/a
☐ Neni 164/a	☐ Neni 257/a	☐ Neni 319/b
☐ Neni 244	☐ Neni 258	☐ Neni 319/c
☐ Neni 244/a	☐ Neni 259	☐ Neni 319/ç
☐ Neni 245	☐ Neni 259/a	☐ Neni 319/d
☐ Neni 245/1	☐ Neni 260	☐ Neni 319/dh
☐ Neni 248	☐ Neni 312	☐ Neni 319/e
☐ Neni 256	☐ Neni 319	

4) Vendimi i
Gjykatës së Apelit
dhe Personat e
Dënuar:

☐ Hiqet dorë nga ankimi

☐ Mospranik i ankimit

☐ Akuzë e re e cila nuk klasifikohet si rast korrupsioni

☐ Kthyer për hetim të mëtejshme

☐ Transferuar në një gjykatë tjetër

☐ Lë në fuqi vendimin

☐ Ndryshon vendimin

☐ Prish vendimin e pushon çështjen

☐ Prish vendimin o i kthen aktet gjykatës së shkallës së parë.

☐ Cështja pezullohet

Numri dhe Data e Vendimit:

4) Vendimi i Gjykatës së Lartë

- ☐ Mospranin i rekursit
- ☐ Lë në fuqi vendimin ndaj të cilit është lënë rikure
- ☐ Ndryshon vendimin e rekursuar:
- ☐ Ndryshon cilësimi ligjor i veprës penale
- ☐ Lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit
- ☐ Ndryshon vendimin e rekursuar:
- ☐ Prish vendimin dhe zgjidh çështjen
- ☐ Prish vendimin dhe kthen aktet për rishtyrtim
- ☐ Prish vendimin e Gjykatës së Apelit dhe lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë

Numri dhe Data e vendimit:

Lloji i Dënimit: ☐ Dënim me burg ☐ Dënim me Gjobë ☐ Të dyja

6) Numri i Personave të Dënuar

Numri i personave të dënuar:

Pozicioni 1:

Pozicioni 5:

Pozicioni 2:

Pozicioni 6:

Pozicioni 3:

Pozicioni 7:

Pozicioni 4:

Pozicioni 8:

5) Nenot e Korrupsionit dhe Lloji i Dënimit të Gjykatës

- | | | |
|-------------------------------------|-------------------------------------|--------------------------------------|
| ☐ Neni 135 | ☐ Neni 257 | ☐ Neni 319/b |
| ☐ Neni 164/a | ☐ Neni 257/a | ☐ Neni 319/b |
| ☐ Neni 244 | ☐ Neni 258 | ☐ Neni 319/c |
| ☐ Neni 244/b | ☐ Neni 259 | ☐ Neni 319/c |
| ☐ Neni 245 | ☐ Neni 259/a | ☐ Neni 319/d |
| ☐ Neni 245/1 | ☐ Neni 260 | ☐ Neni 319/dh |
| ☐ Neni 248 | ☐ Neni 312 | ☐ Neni 319/e |
| ☐ Neni 256 | ☐ Neni 319 | |

Vendimi është i formës së prerë